



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 752
Datë: 11 / 5 / 2021

Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës, mbështetur në nenet 7, 9 dhe 23 të Statutit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", në mbledhjen e mbajtur me datën 22.4.2021, miratoi këtë:

**RREGULLORE PËR PARANDALIMIN DHE MBROJTJEN NGA NGACMIMI
SEKSUAL DHE NGACMIMI NË UNIVERSITETIN E PRISHTINËS**

Parimet e përgjithshme

Ngacmimi dhe ngacmimi seksual janë në kundërshtim me parimin e trajtimit të barabartë mbi bazat e gjinisë, seksit dhe identitetit gjinor dhe përbëjnë diskriminim në bazë të gjinisë. Si forma të shkeljes së të drejtave të njeriut, ato janë të ndaluara dhe duhet të jenë subjekt i përgjegjësisë efektive institucionale si dhe ndëshkimeve të efektshme, proporcionale dhe bindëse.

Në pajtim me Statutin e Universitetit të Prishtinës, studentët, personeli akademik, joakademik dhe administrativ kanë për detyrë që të respektojnë barazinë gjinore, mosdiskriminimin, parimet e ndershmërisë, kodin etik, reputacionin e universitetit, si dhe të kultivojnë dhe promovojnë frymën e humanizmit dhe gjithëpërfshirjes.

Kjo rregullore është nxjerrë në funksion të ruajtjes dhe promovimit të standardeve më të larta të mësimdhënies, mësimnxënies dhe krijimit të një ambienti të sigurt dhe të lirë nga diskriminimi për studentët, personelin akademik, joakademik dhe administrativ, të afërmojë të drejtat e individëve në vendin e punës si dhe në ambiente arsimore.

I. Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Fushëveprimi

Kjo rregullore zbatohet për të gjithë personelin akademik, joakademik dhe administrativ të punësuar në Universitetin e Prishtinës, pavarësisht nga forma dhe lloji i kontratës apo niveli i emërimit, duke përfshirë por pa u kufizuar në profesor asistent, profesor i asociuar, profesor i rregullt, asistent, lektor, profesor vizitues, referent si dhe të punësuarit apo të angazhuarit tjerë në Universitetin e Prishtinës, si dhe studentët e Universitetit të Prishtinës.

Neni 2

Qëllimi

1. Kjo rregullore përcakton rregullat materiale, procedurat disiplinore dhe masat e zbatueshme në rastet e ngacmimit dhe ngacmimit seksual në Universitetin e Prishtinës dhe ka për qëllim që:
 - a) të ofrojë ambient të sigurt, të lirë, ku të gjithë të ndihen të barabartë në vendin e punës dhe në ambientet arsimore, pavarësisht dallimeve gjinore dhe/ose seksuale;
 - b) të sigurojë mbrojtje efikase nga diskriminimi në baza gjinore dhe/ose seksuale;
 - c) të përcaktojë masa të sakta lidhur me përgjigjen efektive dhe të menjëhershme në trajtimin e rasteve të ngacmimit seksual në Universitetin e Prishtinës;
 - d) të parandalojë që personi i prekur nga ngacmimi seksual të pengohet në punë, në zhvillimin e studimeve, në ndjekjen e avancimit profesional, diplomimit ose karrierës akademike e profesionale;
 - e) të përcaktojë masa afirmative për individët dhe grupet që janë apo mund jenë të prekur nga kjo dukuri.

Neni 3

1. Ngacmimi dhe ngacmimi seksual janë të ndaluar dhe paraqesin shkelje të rënda disiplinore që ndëshkohen sipas masave disiplinore të parapara në këtë rregullore.
2. Në marrjen e vendimeve dhe masave disiplinore në procedurën për shqyrtimin e denoncimeve për ngacmim apo ngacmim seksual, Këshilli i Etikës zbaton këtë rregullore, Statutin e Universitetit të Prishtinës, Ligjin për Arsim të Lartë, Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi, Ligjin për Barazi Gjinore, Ligjin e Punës dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore të zbatueshme.

Neni 4

Përkufizimet

Në këtë rregullore termat e mëposhtëm i kanë këto kuptime, me kusht që ato nuk janë pjesë e diskursit të ligjëratave, ushtrimeve (procesit mësimor) në Universitetin e Prishtinës:

1. **Ngacmim seksual** – nënkupton çfarëdo forme të sjelljes së padëshiruar verbale, joverbale apo fizike të natyrës seksuale dhe/apo psikologjike, me qëllim apo pasojë prekjen apo shkeljen e dinjitetit të një personi dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqësor, degradues, nënçmues apo fyes. Ngacmimi seksual i përfshin por nuk kufizohet në përkufizimet e përcaktuara në këtë dispozitë.
2. **Ngacmim** – nënkupton çfarëdo forme të sjelljes së padëshiruar mbi bazat e kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, lindjes, origjinës, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar dhe besimit, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale ose personale, moshës, gjendjes familjare ose martesore, shtatëzënisë, lehonisë, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, aftësisë së

kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë baze tjetër, që ka për qëllim apo që ka për pasojë preken apo shkeljen e dinjitetit të një personi dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqësor, degradues, nënçmues apo fytes. Ngacmimi i përfshin por nuk kufizohet në përkufizimet e përcaktuara në këtë dispozitë.

3. **Shkelja e dinjitetit** – përcaktohet si veprim i cili:
 - a) zvogëlon vetërespektin e personit, duke e vendosur atë në pozitë inferiore dhe në varësi;
 - b) trajton personin si instrument ose si mjet për arritjen e qëllimit dhe interesit;
 - c) zvogëlon vlerën e cila karakterizon çdo person si anëtar të barabartë dhe me vlerë njerëzore;
 - d) privon personin nga vlerat e tij/saj njerëzore.
4. **Barazi gjinore** – është ushtrimi i plotë e i barabartë i të drejtave të njeriut nga burrat dhe gratë, si dhe mosprania e diskriminimit në bazë gjinore në mundësitë, ndarjen e burimeve apo përfitimeve si dhe qasjen në shërbime.
5. **Ngacmim verbal** – konsiderohen komentet mbi trupin, barsoletat, pyetjet provokuese, komentet e natyrës seksuale, shprehjet fyese, epitetet poshtëruese, formulimet nënçmuese ose shpërdorimet tjera. Ngacmimi verbal përfshin por nuk kufizohet në veprimet si në vijim:
 - a) kërkesë për marrëdhënie seksuale;
 - b) kërkesë dhe këmbëngulje për marrëdhënie seksuale, të përcjella me kërcënime ose për takim intim apo privat ose kushtëzim *quid pro quo*;
 - c) thirrje telefonike ngacmuese duke përfshirë edhe mesazhet SMS nëpërmjet telefonave të dorës, mesazhet përmes postës elektronike, rrjeteve sociale, aplikacioneve tjera apo mënyrave tjera të komunikimit;
 - d) insistim për takim privat apo intim;
 - e) komentet seksuale ose barsoleta mbi veshjet, anatominë, atributet fizike ose dukjen e personit.
6. **Ngacmim fizik** – përfshin por nuk kufizohet në veprimet e padëshiruara si në vijim:
 - a) masazhi i qafës ose i supeve;
 - b) prekja e qëllimshme e teshave, e flokëve ose trupit të personit;
 - c) përqafimi, puthja, përkëdhelja;
 - d) prekja e qëllimshme e natyrës seksuale;
 - e) vetëkënaqje seksuale në praninë e personit tjetër;
 - f) fërkimi me personin tjetër.
5. **Ngacmim joverbal** – përfshin por nuk kufizohet në veprimet si në vijim: gjestet provokuese me lëvizje dhe prekje provokuese të pjesëve të ndryshme të trupit të personit që provokon personin tjetër sikurse ekspozim të reklamave, fotografive dhe shenjave pornografike, vizatime ose komente seksuale për veshjen.
6. **Quid pro quo** – (një favor për një favor) - ka të bëjë me situatat në kuadër të raporteve zyrtare, në rend të parë raporteve në vendin e punës, ku vendimet në interes

të personit kushtëzohen me pranimin e propozimeve, kërkesave apo sjelljeve seksuale, të cilat para personit i shtron personi zyrtar me pozitën më të lartë në hierarkinë profesionale dhe ndaj të cilit personi - viktimë është në raport të varësisë. Kërkesë për seks si kushtëzim për pozitë më të lartë, punësim apo për përfitime tjera si: presion i vazhdueshëm ose kërkesë për qëllime seksuale. Ngacmimi seksual *quid pro quo* përfshin por nuk kufizohet në:

- a) veprimi me të cilin personi në pozitën me të lartë zyrtare apo profesionale/akademike kushtëzon me shërbime seksuale punësimin, avancimin, rritjen e pagës, regjistrimin në fakultet, kalimin e provimeve, vlerësimin ose ndonjë tjetër privilegj ndaj studentit apo ndaj personit në pozitën më të ulët apo të njëjtë zyrtare apo profesionale/akademike;
 - b) kërcënimi i personit (vartësit) me ndërprerjen e kontratës, zhvendosjen, degradimin ose ndonjë lloj tjetër të ndikimit negativ në pozitën e punës apo pozitën profesionale/akademike në rast se vartësi nuk pranon të hyjë apo të vazhdojë raporte seksuale;
 - c) premtim ose sigurim të rritjes së pagës ose të avancimit të vartësit në këmbim të shërbimeve ose premtimeve për shërbime seksuale;
 - d) veprimi përmes të cilit personi në pozitën më të lartë zyrtare apo profesionale/akademike i ofron vartësit një detyrë të veçantë apo mundësi për ta dëshmuar veten, mundësinë e udhëtimeve zyrtare apo pjesëmarrjes në ngjarjet profesionale të rëndësishme për karrierën e tij/saj dhe pret që vartësi këto mundësi të ofruara t'i shpaguajë me shërbime seksuale.
7. **Seksualizimi i ambientit të punës ose mësimin** – Ky lloj i ngacmimit seksual nuk përfshin domosdoshmërisht kërkesa për shërbime seksuale, respektivisht hyrje në raporte seksuale, por është i përqendruar në forma të ndryshme të veprimeve verbale ose joverbale të natyrës seksuale, të cilat e reduktojnë personin tjetër në objekt seksual, në mënyrë të drejtpërdrejtë, me qëllim apo pa qëllim, me çfarë zvogëlohet reputacioni i tij/saj, statusi profesional respektivisht mundësia e zhvillimit profesional. Ky lloj i ngacmimit seksual përfshin por nuk kufizohet në:
- a) shpërndarje e videoincizimeve ose fotografive me përmbajtje pornografike;
 - b) dërgimi i letrave sugjестive, shënimeve dhe emailave me përmbajtje të natyrës seksuale;
 - c) barsoletat ose anekdotat seksuale;
 - d) gjestet e pavend të natyrës seksuale.

Neni 5

Përgjegjësitë e Universitetit të Prishtinës për parandalimin dhe mbrojtjen nga ngacmimi dhe ngacmimi seksual

1. Anëtarët e personelit akademik, joakademik, administrativ dhe studentët duhet të kenë konsideratë për njëri-tjetrin dhe duhet t'i respektojnë kufijtë personal të njëri-tjetrit.

2. Universiteti zhvillon dhe harton Planin e Veprimit për parandalimin e rasteve të ngacmimit dhe të ngacmimit seksual në universitet dhe mbikëqyr zbatimin e tij në universitet.
3. Universiteti ndërmerr masa parandaluese që të informojë, edukojë dhe komunikojë me studentët, personelin akademik, joakademik dhe administrativ në lidhje me parandalimin dhe sanksionimin e ngacmimit dhe ngacmimit seksual në vendin e punës dhe ambientet arsimore.
4. Universiteti i bën të dukshme informatat lidhur me përmbajtjen e kësaj rregulloreje në hapësirat e fakulteteve, njofton studentët, personelin akademik dhe joakademik dhe administrativ se ku ushtrohen raportimet për rastet e ngacmimeve dhe ngacmimeve seksuale si dhe edukon mbi masat parandaluese, raportuese dhe hetuese. Informatat për denoncimin dhe raportimin e rasteve të ngacmimit dhe ngacmimit seksual duhet të jenë lehtë të qasshme për studentët edhe në ueb faqet zyrtare të fakulteteve si dhe duhet ofruar numri kontaktues anonim për këshilla dhe referim të mëtutjeshëm.
5. Universiteti ndjek procedurat e veprimit, të parapara në Planin e Veprimit dhe në këtë rregullore dhe zbaton masa disiplinore në raste të ngacmimit ose ngacmimit seksual sipas kësaj rregulloreje, Rregullores për Procedurat Disiplinore të aplikueshme për studentë në Universitet të Prishtinës dhe Kodi i Etikës së Stafit Akademik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”.
6. Pas pranimit të denoncimit nga pala ankuese, universiteti merr masa të menjëhershme sipas kësaj rregullore për ndalimin e vazhdimin të ngacmimit seksual dhe ngacmimit.

Neni 6

Edukimi për parandalimin e ngacmimeve dhe ngacmimeve seksuale

1. Universiteti siguron mjedis, i cili përkrah dijen, praktika dhe politika, për të eliminuar ngacmimin, ngacmimin seksual dhe të gjitha format e diskriminimit.
2. Universiteti i Prishtinës mund të nxjerrë udhëzues sipas nevojës për sqarimin e procedurës për parandalimin e diskriminimit dhe ngacmimeve seksuale.
3. Rektorati dhe njësitë akademike obligohen t’u ofrojnë qasje të lehtë studentëve, personelit akademik, joakademik dhe administrativ, në informata dhe aktet ligjore dhe nënligjore, të cilat e trajtojnë ngacmimin dhe ngacmimin seksual.

Neni 7

Zyrtari për implementim të politikave për mbrojtje nga ngacmimi dhe ngacmimi seksual

1. Universiteti i Prishtinës do të emërojë një zyrtar për implementimin e politikave për mbrojtje nga ngacmimi dhe ngacmimi seksual (“Zyrtari për mbrojtje nga ngacmimi”) që do të jetë përgjegjës për informimin, këshillimin dhe pranimin e denoncimeve për ngacmim dhe ngacmim seksual në Universitetin e Prishtinës.
2. Zyrtari për mbrojtje nga ngacmimi raporton një herë në vit, në muajin mars, para këshillit drejtues të universitetit ose para senatit të universitetit, ndër të tjera në lidhje me zbatimin e Planit të Veprimit, numrin e rasteve të paraqitura për këshillim, numrin

e rasteve të hetuara, rasteve të përmbyllura dhe masave të shqiptuara ndaj personave përgjegjës për ngacmim dhe ngacmim seksual.

Neni 8

Përgjegjësitë e personelit të Universitetit të Prishtinës

Kushdo nga personeli akademik, joakademik dhe administrativ që vëren sjellje që janë në mospërputhje me këtë rregullore ka për detyrë t'i kërkojë personit që të ndalojë sjelljen e padëshirueshme dhe e ka për detyrë ta informojë palën e prekur për të drejtën e paraqitjes së denoncimit si dhe ta drejtojë te zyrtari për mbrojtje nga ngacmimi për të marrë më shumë informata për procedurën.

Neni 9

Paraqitja e denoncimit për ngacmim ose ngacmim seksual

1. Subjekti raportues mund ta paraqesë denoncimin formal dhe joformal për ngacmim ose ngacmim seksual te zyrtari për mbrojtje nga ngacmimi. Denoncimin formal subjekti raportues mund ta paraqesë edhe drejtpërsëdrejti në Rektorat të Universitetit të Prishtinës, duke iu drejtuar Këshillit të Etikës së Universitetit të Prishtinës.
2. Denoncimi joformal i ngacmimit ose ngacmimit seksual mund të paraqitet nga subjekti raportues kur ai/ajo nuk është i/e sigurt në lidhje me atë nëse dëshiron të bëjë edhe denoncim formal. Denoncimet joformale mund të jenë verbale dhe me shkrim (në kopje fizike ose përmes postës elektronike në email në adresën zyrtare të zyrtarit për mbrojtje nga ngacmimi seksual). Në rast të denoncimit joformal verbal, denoncimi duhet të evidentohet nga zyrtari për mbrojtje nga ngacmimi. Asnjë veprim nuk do të ndërmerret nga zyrtari për mbrojtje nga ngacmimi, përveç në rastet kur nga denoncimi joformal, zyrtari për mbrojtje nga ngacmimi e vlerëson se subjekti raportues mund të jetë në rrezik immanent. Në këtë rast, zyrtari për mbrojtje nga ngacmimi mund të denoncojë rastin te Këshilli i Etikës së Universitetit të Prishtinës dhe për këtë duhet ta njoftojë paraprakisht subjektin raportues.
3. Denoncimi formal i ngacmimit ose ngacmimit seksual paraqitet nga subjekti raportues në formë të shkruar në kopje fizike ose përmes postës elektronike në email adresën zyrtare të zyrtarit për mbrojtje nga ngacmimi seksual ose në shkrimoren e Rektoratit të Universitetit të Prishtinës apo në email adresën zyrtare të Rektoratit të Universitetit të Prishtinës. Për shkaqe të kësaj rregulloreje, nëse subjekti raportues, pas denoncimit joformal, vendos që të bëjë denoncim formal, denoncimi i tillë duhet t'i përmbushë kushtet e këtij paragrafi dhe paragrafit 4 të kësaj rregulloreje, në mënyrë që të trajtohet si denoncim formal.
4. Denoncimi formal i ngacmimit ose ngacmimit seksual duhet të jetë i qartë, duhet ta identifikojë subjektin raportues dhe subjektin e dyshuar dhe duhet ta shpjegojë sjelljen e subjektit të dyshuar, për të cilën paraqitet denoncimi, efektin e sjelljes të subjektit raportues dhe duhet të përfshijë datat dhe informatat tjera në lidhje me rastin. Në qoftë se ka dëshmitarë apo dëshmi shtesë, ato duhet t'i bashkëngjiten denoncimit.
5. Subjekti raportues mund të paraqesë denoncim për ngacmim ose ngacmim seksual sipas kësaj rregulloreje, jo më vonë se një (1) vit nga dita e ndodhjes së shkeljes.

6. Zyrtari për mbrojtje nga ngacmimi e protokollon rastin e denoncuar (formal dhe joformal) në regjistra të veçantë të raportimeve fizike dhe/apo online për ngacmime seksuale dhe i mban dosjet e raportimeve fizike dhe/apo online në një vend të sigurt.
7. Denoncuesi obligohet që krahas provave dhe fakteve të paraqitura, ta nënshkruajë deklaratën për përgjegjësitë morale, etike, disiplinore dhe penale që bart lidhur me denoncimin.

Neni 10

Regjistrimi i denoncimit joformal dhe formal dhe hapat fillestarë procedural

1. Zyrtari për mbrojtje nga ngacmimi pranon denoncimet formale dhe joformale për ngacmim dhe ngacmim seksual, këshillon dhe informon palët në lidhje me procedurat e paraqitjes së denoncimit joformal dhe formal dhe zhvillimin e procedurave disiplinore.
2. Zyrtari për mbrojtje nga ngacmimi ndihmon subjektet raportuese në përpilimin e denoncimit formal me shkrim, e protokollon rastin e denoncuar dhe e plotëson një formular standard me informacione relevante për rastin.
3. Zyrtari për mbrojtje nga ngacmimi mban evidencë të të gjitha rasteve të denoncimit joformal dhe formal. Palët që kërkojnë informata dhe këshillim (denoncim joformal) mund të mbesin anonime deri në momentin e paraqitjes së denoncimit formal.
4. Të gjithë personat zyrtarë të universitetit, të cilët janë të përfshirë në trajtimin e rasteve të ngacmimit seksual, i nënshtrohen obligimit të rreptë për konfidencialitet. Shkelja e obligimit për konfidencialitet për procedurat sipas kësaj rregulloreje paraqet shkelje të rëndë disiplinore. Informata konfidenciale përfshijnë të dhënat e subjektit raportues, subjektit të dyshuar, rrethanat e rastit, datat, sjelljet e subjekteve dhe informata tjera në lidhje me rastin.
5. Zyrtari për mbrojtje nga ngacmimi menjëherë pas pranimit të denoncimit formal nga subjekti raportues, e jo më larg se njëzetekatër (24) ditë pune pas pranimit të denoncimit formal, e njofton zyrtarisht Këshillin e Etikës për rastin dhe ia dërgon denoncimin formal, bashkë me dokumentet tjera përcjellëse.
6. Zyrtari për mbrojtje nga ngacmimi mban kontakt të vazhdueshëm me subjektin raportues, për t'u siguruar që ngacmimi seksual është ndërprerë dhe përgatit raporte për ta dokumentuar komunikimin me subjektin raportues.

Neni 11

Procedura disiplinore

1. Procedura e shqyrtimit të denoncimeve për ngacmim ose ngacmim seksual duhet të zhvillohet në procedurë të përsheptuar dhe rastet e denoncuar, sipas kësaj rregulloreje, duhet të trajtohen me prioritet nga Këshilli i Etikës.
2. Barra e provës në procedurën e shqyrtimit të denoncimit për ngacmim ose ngacmim seksual bie mbi palët procedurale, sipas parimit të barazisë së palëve (denoncuesi/ja i ofron provat, ndërsa të denoncuarit/es i jepet mundësia e mbrojtjes).

3. Këshilli i Etikës e kontakton subjektin e dyshuar menjëherë pas pranimit të denoncimit dhe e fton në intervistim, jo më vonë se pesë (5) ditë kalendarike pas pranimit të denoncimit formal për ngacmim ose ngacmim seksual, duke u siguruar që subjekti i dyshuar është njoftuar dy (2) ditë më herët.
4. Në vlerësimin e denoncimit, Këshilli i Etikës i organizon së paku 2 seanca dëgjimore, një në fillim të procedurës dhe një në fund të saj, për t'i shqyrtuar provat dhe për t'i marrë në pyetje dëshmitarët, subjektin raportues dhe subjektin e dyshuar. Subjekti i dyshuar i gëzon të gjitha të drejtat procedurale për dëgjim dhe trajtim të drejtë. Palët mund të thirren në rregullat procedurale të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative gjatë zbatimit të procedurës disiplinore për çështjet që nuk janë të parapara në këtë rregullore.
5. Këshilli i Etikës merr vendim, me të cilin konstaton a është kryer apo jo shkelja e paraqitur në denoncim sipas kësaj rregulloreje. Nëse Këshilli i Etikës e konstaton shkeljen, shqipton masa sipas kësaj rregulloreje. Vendimi i Këshillit të Etikës është vendim përfundimtar në shkallë të parë.
6. Në fund të vendimit, pala e pakënaqur udhëzohet në të drejtën e ushtrimit të mjetit juridik. Pala e pakënaqur me vendimin e Këshillit të Etikës ka të drejtë të paraqesë ankesë në Senatin e Universitetit të Prishtinës brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh pas pranimit të vendimit të Këshillit të Etikës. Senati merr vendim për ankesën ndaj vendimit të Këshillit të Etikës në seancë të mbyllur, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas afatit të fundit për paraqitjen e ankesës. Vendimi i senatit është vendim përfundimtar në nivel të universitetit. Pala e pakënaqur me vendimin e senatit mund të paraqesë ankesë pranë inspektoratit përkatës apo mund të paraqesë padi për konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë sipas legjislacionit në fuqi.
7. Universiteti i Prishtinës do të zbatojë masat dhe procedurat disiplinore për rastet e ngacmimit dhe ngacmimit seksual, pavarësisht nga zhvillimi i procedurës penale për rastin e njëjtë.
8. Universiteti i Prishtinës rezervon të drejtën të ndërmarrë veprime ligjore te organet e rendit ndaj personit që konstatohet se është përgjegjës për ngacmim ose ngacmim seksual sipas kësaj rregulloreje.

Neni 12

Masat për shkeljet disiplinore

1. Këshilli i Etikës, pasi të vlerësojë rrethanat e rastit konkret, personit përgjegjës për shkeljet e kryera sipas kësaj rregulloreje ia shqipton njërën nga masat ndëshkuese në vijim:
 - 1.1. Për studentë:
 - a) Paralajmërim për suspendim/përrjashtim;
 - b) Suspendim nga fakulteti për një (1) vit;
 - c) Përrjashtim nga fakulteti përgjithmonë.
 - 1.2. Për personelin akademik, joakademik dhe administrativ:

- a) Paralajmërim për suspendim/ndërprerje të marrëdhënies së punës;
 - b) Suspendim i përkohshëm pa pagesë;
 - c) Ndërprerje e marrëdhënies së punës.
2. Përfundimisht nga masat e parapara në paragrafin 1, pikat 1.1. dhe 1.2. të këtij neni, për masat të cilat nuk janë paraparë në këtë rregullore, duhet t'i referohemi rregullores në fuqi për masat dhe procedurat disiplinore për studentët e UP-së dhe rregullores për masat dhe procedurat disiplinore ndaj personelit akademik të UP-së.

Neni 13

Denoncimi i rrejshëm dhe përdorimi i denoncimit kundër subjektit raportues

1. Deklarimi apo denoncimi i rrejshëm është vepër penale e ndëshkueshme me ligjet në fuqi.
2. Deklarimi apo denoncimi i rrejshëm i personit për ngacmim ose ngacmim seksual përbën edhe shkelje të rëndë disiplinore. Deklarim apo denoncim të rrejshëm kryen kushdo që bën deklaram apo denoncim të rremë te personi zyrtar i ngarkuar për pranimin e denoncimeve për ngacmim ose ngacmim seksual, duke e ditur se subjekti i dyshuar nuk ka kryer ngacmim ose ngacmim seksual. Kjo dispozitë nuk aplikohet në rastet kur personi ka paraqitur denoncimin dhe informatat janë në mirëbesim, edhe nëse faktet e pretenduara vlerësohen si të pasakta.
3. Ndaj personit përgjegjës, për deklaram apo denoncim të rrejshëm të ngacmimit seksual, do të iniciohet procedurë disiplinore pranë Këshillit të Etikës së Universitetit dhe do të ndërmerren masa disiplinore në përputhje me rregulloren për masat dhe procedurat disiplinore ndaj personelit akademik, joakademik dhe administrativ të Universitetit të Prishtinës. Kur personi përgjegjës për deklaram apo denoncim të rrejshëm të ngacmimit seksual është student, do të iniciohet procedura disiplinore në përputhje me këtë rregullore dhe Rregulloren për Procedurën Disiplinore, të aplikueshme për studentë të Universitetit të Prishtinës.
4. Denoncimi për ngacmim ose ngacmim seksual nuk mund të përdoret kundër subjektit raportues për ndërprerje të marrëdhënies së punës, ose për paraqitje të pengesave për vazhdimin e shkollimit apo të pengesave tjera.
5. Në raste kur ngacmimi ose ngacmimi seksual kryhet nga personi që ka pozitë të autoritetit ndaj personit tjetër, nënshtrimi ndaj ngacmimit ose ngacmimit seksual nuk mund të përdoret si rrethanë kundër subjektit raportues në procedurën vendimmarrëse.

Dispozitat përfundimtare

Neni 14

1. Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen përshtatshëmrisht edhe në raste të paraqitjes së denoncimit për dhunim, tentim dhunim, sulm seksual dhe të gjitha rastet e paraqitura të diskriminimit në universitet.
2. Procedurat e përcaktuara në këtë rregullore zhvillohen pavarësisht nga procedura penale apo procedurat tjera dhe mund të zhvillohen edhe njëkohësisht.

3. Dispozitat e kësaj rregulloreje mbizotërojnë në rast të konfliktit me aktet tjera nënligjore të universitetit, përveç dispozitave ligjore dhe statutare. Zbatimi i kësaj rregulloreje mbikëqyret nga Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës. Interpretimin e kësaj rregulloreje e jep Këshilli Drejtues.
4. Këshilli i Etikës i Universitetit obligohet që ta zbatojë këtë rregullore.

Neni 15

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës.



Dr. sc. Ujkan Bajra, kryesues

Këshilli Drejtues i UP-së